ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-26-7130-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Pajisje Mjekësore për KPSH**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**SENTIMED SH.P.K.**
NUI	**811499781**
Adresa	**Ali Vitija, Kompleksi Model Sllovenia, A1/2,**
Vendi	**Prishtina**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Defrim Sahitaj**
Adresa elektronike	**support@sentimed-ks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**02.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lot 3- Furnizim me Karrige gjinekologjike dhe pajisje tjera per KPSH

Autoriteti Kontraktues Ministra e Shëndetësisë e ka shpallur të papërgjegjshme ofertën tonë të GOE SENTIMED SH.P.K. dhe Swissmed sh.p.k., duke u mbështetur në tri pretendime për mospërputhje me specifikimet teknike të dosjes së tenderit. Vlerësojmë se ky përfundim është i pabazuar, pasi dokumentacioni teknik i dorëzuar në ofertën tonë, së bashku me karakteristikat e pajisjeve të ofertuara, dëshmojnë se kërkesat përkatëse duhet të vlerësohen në mënyrë tjetër nga ajo që ka bërë Autoriteti Kontraktues.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Po. Më 20.10.2026 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke paraqitur pretendimet tona ankimore lidhur me eliminimin. Më 23.10.2026 kemi pranuar vendimin e AK-së, përmes të cilit kërkesa për rishqyrtim është refuzuar. N ë rishqytrim është aprovu vetem njëra nga pretendimet tona.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP):

Neni 6 - Ekonomia dhe efikasiteti;

Neni 7 - Barazia në trajtim / Mosdiskriminimi;

Neni 10 - Mjetet për promovimin e transparencës;

Neni 11 - Qasja në dokumentacionin e tenderit;

Neni 59, paragrafi 2 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

- Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik:

Neni 7 - Qasja në dokumentacion;

Neni 38.1 - Sqarimi i tenderëve.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

MOHIMI I QASJES NË OFERTËN E OPERATORIT TË REKOMANDUAR PËR KONTRATË DHE PAMUNDËSIMI I IDENTIFIKIMIT DHE ARGUMENTIMIT TË PLOTË TË SHKELJEVE EVENTUALE NË OFERTËN E TIJ

Menjëherë pas pranimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, kemi parashtruar kërkesë për qasje në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues, në kundërshtim me dispozitat ligjore, na ka refuzuar qasjen në tërë dokumentacionin GOE MADEKOS SH.P.K. dhe GENIUS KOSOVA SH.P.K., të rekomanduar për kontratë, me arsyetimin se dokumentet e ofertës janë klasifikuar si sekret afarist. Për më tepër, AK-ja nuk ka përgatitur dhe nuk na ka ofruar versionin e pastruar të dokumenteve, përmes të cilit do të mundësohej qasja në informacionet që nuk përbëjnë sekret afarist. Një veprim i tillë përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 10 dhe nenit 11, paragrafët 3 dhe 4 të LPP-së, si dhe të dispozitave përkatëse të legjislacionit sekondar për prokurimin publik.

Sipas nenit 11, paragrafi 3 të LPP-së, klasifikimi i informatave si sekret afarist nuk mund të bëhet në mënyrë të përgjithshme dhe automatike, por duhet të mbështetet në arsyetim konkret dhe në dëshmi që bindshëm demonstrojnë se publikimi i informatave përkatëse do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik. Vetëm deklarimi i një dokumenti apo i tërë ofertës si konfidenciale nuk përbën bazë të mjaftueshme ligjore për mohimin e qasjes. Autoriteti Kontraktues ka detyrimin që të shqyrtojë në mënyrë individuale informacionet e klasifikuara dhe të vlerësojë nëse ato i përmbushin kriteret ligjore për mbrojtjen e sekretit afarist. Për më tepër, neni 11, paragrafi 4 i LPP-së përcakton shprehimisht detyrimin e AK-së për përgatitjen e versionit të pastruar të çdo dokumenti, kur në të njëjtin dokument gjenden informacione konfidenciale dhe informacione që nuk konsiderohen sekret afarist. Rrjedhimisht, edhe nëse disa informacione të caktuara të ofertës do të përmbushnin kriteret për mbrojtje, kjo nuk e autorizon AK-në të refuzojë qasjen në tërë dokumentacionin e ofertës. Për rëndësinë e kësaj çështjeje në ushtrimin efektiv të së drejtës për ankesë, i referohemi veçanërisht praktikës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, konkretisht vendimit në ankesën nr. **877/23**, ku ekspertja shqyrtuese ka konstatuar se mohimi i qasjes në dokumente ua pamundëson operatorëve ekonomikë konkurrues mbledhjen e informatave konkrete dhe të nevojshme, të cilat mund të përdoren për ushtrimin e të drejtës për ankesë. Në atë rast, ekspertja ka trajtuar edhe situatën kur operatori ankues, pavarësisht mungesës së qasjes në ofertën e operatorit të rekomanduar, kishte ngritur pretendime lidhur me papërgjegjshmërinë e tij. Megjithatë, ekspertja nuk e ka konsideruar këtë rrethanë si arsye për ta mohuar rëndësinë e shkeljes së së drejtës për qasje, por ka vlerësuar se AK-ja duhet të mundësojë qasjen dhe të përgatisë versionet e pastruara të dokumenteve. Madje, në arsyetimin e vendimit, Paneli Shqyrtues ka theksuar se nuk është lëshuar në konstatime lidhur me përgjegjshmërinë e operatorit të rekomanduar, pikërisht për shkak se pala ankimore nuk kishte pasur qasje të plotë në ofertën e tij. Ky konstatim është veçanërisht domethënës për rastin konkret, pasi dëshmon se mungesa e qasjes nuk është vetëm shkelje formale e transparencës, por mund të pengojë drejtpërdrejt edhe shqyrtimin e ligjshmërisë së ofertës së rekomanduar për kontratë. Kësisoj nga ana e panelit ishte aprovuar ankesa dhe lënda ishte kthyer **në**

rivlerësim.

Në të njëjtën linjë, i referohemi edhe vendimit të OSHP-së në ankesën nr. **471/2025**, ku Paneli Shqyrtues e ka aprovuar ankesën si të bazuar dhe aktivitetin e prokurimit e ka kthyer **në rivlerësim**, pasi autoriteti kontraktues nuk kishte lejuar qasjen në dokumentet e klasifikuara si sekret afarist dhe nuk kishte përgatitur versionin e pastruar të tyre, në kundërshtim me nenin 11, paragrafin 4 të LPP-së dhe nenin 7.6.3 të Rregullores nr. 002/2024. Kjo praktikë konfirmon se detyrimi për përgatitjen e versionit të pastruar nuk është çështje diskrecionale e autoritetit kontraktues, por obligim ligjor.

Në rastin konkret, mohimi i qasjes në tërë ofertën e GOE MadeKos na ka pamundësuar verifikimin e dokumentacionit mbi të cilin AK-ja ka mbështetur rekomandimin për dhënie të kontratës, përfshirë dëshmitë për përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit dhe specifikimeve përkatëse të këtij aktiviteti të prokurimit. Kjo rrethanë ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në mundësinë tonë për të identifikuar dhe argumentuar në mënyrë të plotë pretendimet ankimore. Megjithatë, pavarësisht këtij kufizimi të imponuar nga vetë AK-ja, kemi arritur të identifikojmë dhe të paraqesim pretendime ankimore konkrete lidhur me ofertën e operatorit të rekomanduar, të cilat kërkojnë shqyrtim dhe verifikim mbi bazën e dokumentacionit origjinal të ofertës.

Në rastin konkret, kjo shkelje merr një dimension edhe më serioz për faktin se çështjen e klasifikimit të tërë ofertës së GOE MADEKOS SH.P.K. dhe GENIUS KOSOVA SH.P.K. si sekret afarist e kemi ngritur shprehimisht edhe në Kërkesën për Rishqyrtim, duke identifikuar dispozitat ligjore të shkelura, duke argumentuar pse një klasifikim i tillë i përgjithshëm nuk është në përputhje me nenin 11 të LPP-së dhe duke kërkuar konkretisht verifikimin e ligjshmërisë së këtij klasifikimi, qasjen në dokumentet që nuk përbëjnë sekret afarist, përgatitjen e versioneve të pastruara dhe, kur është e zbatueshme, të përmbledhjeve të përgjithshme jo-sekrete. Megjithatë, nga përgjigjja e Autoritetit Kontraktues rezulton se kjo çështje nuk është trajtuar fare. AK-ja nuk ka dhënë asnjë vlerësim nëse dokumentet e ofertës së rekomanduar i përmbushin kriteret ligjore për t'u klasifikuar si sekret afarist, nuk ka identifikuar se cilat informata konkretisht meritojnë mbrojtje, nuk ka arsyetuar se si zbulimi i tyre do të shkaktonte dëmtim material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik dhe as nuk ka dhënë ndonjë shpjegim lidhur me mos-përgatitjen e versioneve të pastruara apo të përmbledhjeve jo-sekrete. Pra, një pretendim i ngritur qartë, i mbështetur në dispozita konkrete ligjore dhe i shoqëruar me kërkesa të përcaktuara qartë, është lënë plotësisht pa përgjigje nga AK-ja.

Kjo është veçanërisht problematike sepse, nga njëra anë, AK-ja na ka mohuar qasjen në tërë dokumentacionin e ofertës mbi të cilin është mbështetur rekomandimi për dhënie të kontratës dhe, nga ana tjetër, në shqyrtimin e kërkesës sonë për rishqyrtim nuk ka trajtuar fare kundërshtimin tonë ndaj këtij veprimi. Në këto rrethana, nuk mund të pritet nga ne që të paraqesim pretendime ankimore të detajuara për çdo element të ofertës së MADEKOS dhe GENIUS KOSOVA, kur dokumentacioni përkatës nuk na është vënë në dispozicion

dhe kur vetë AK-ja nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për të siguruar qasje në pjesën jo-konfidenciale të tij. Një qasje e tillë do ta kthente të drejtën për ankesë në një të drejtë vetëm formale, duke i kërkuar operatorit ekonomik të argumentojë shkelje mbi bazën e dokumenteve të cilat i janë mbajtur të paarritshme.

Pikërisht këtë problematikë e ka trajtuar edhe vetë OSHP-ja në vendimin sipas ankesës nr. 877/24, ku ekspertja shqyrtuese ka konstatuar se mohimi i qasjes në dokumente ua pamundëson operatorëve ekonomikë konkurrues mbledhjen e informatave konkrete dhe të nevojshme për ushtrimin e të drejtës për ankesë. Ky vendim ka rëndësi të veçantë për rastin tonë, pasi edhe në atë rast operatori ankues kishte ngritur pretendime për papërgjegjshmërinë e operatorit të rekomanduar, pavarësisht se nuk kishte pasur qasje të plotë në ofertën e tij. Paneli Shqyrtues, duke marrë parasysh këtë rrethanë, nuk ishte lëshuar në vlerësimin e përgjegjshmërisë së operatorit të rekomanduar, pikërisht për shkak të mungesës së qasjes së plotë, ndërsa aktivitetin e prokurimit e kishte kthyer në rivlerësim. Po ashtu, në vendimin sipas ankesës nr. 471/2025, OSHP-ja kishte aprovuar ankesën dhe kishte kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim për shkak se autoriteti kontraktues nuk kishte lejuar qasjen në dokumentet e klasifikuara si sekret afarist dhe nuk kishte përgatitur versionin e pastruar të tyre. Këto vendime dëshmojnë se OSHP-ja e ka trajtuar mohimin e qasjes si çështje me ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtës për ankesë dhe në mundësinë e verifikimit të ligjshmërisë së ofertës së rekomanduar për kontratë.

Për më tepër, përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim e bën edhe më të dukshme këtë problematikë: ndërsa AK-ja ka dhënë vlerësime për pretendimet tona lidhur me butonin emergjent, kërkesën për pajisje monolite dhe vëllimin e mostrës për analizatorin hematologjik Sysmex XN-530, çështjen e mohimit të qasjes në ofertën e operatorit të rekomanduar e ka lënë tërësisht pa trajtim, ndonëse kjo çështje përbënte një nga kërkesat tona të veçanta dhe të argumentuara. Për më tepër, AK-ja i është referuar dokumentacionit teknik të ofertës së operatorit të rekomanduar gjatë shqyrtimit të pretendimeve tona, ndërkohë që neve na është mohuar mundësia për ta shqyrtuar atë dokumentacion. Kjo krijon një pabarazi të qartë procedurale ndërmjet palëve dhe e cenon mundësinë tonë për të kundërshtuar në mënyrë efektive vlerësimin e bërë nga AK-ja.

Prandaj, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që këtë çështje ta trajtojë si pretendim të veçantë dhe thelbësor ankimor, të konstatojë shkeljet e dispozitave të nenit 10 dhe nenit 11 të LPP-së, si dhe të legjislacionit sekondar përkatës për qasjen në dokumentacionin e prokurimit dhe trajtimin e informatave sekrete afariste. Njëkohësisht, kërkojmë që të mos na vihet në barrë mungesa e pretendimeve të mëtejshme lidhur me dokumentacionin e ofertës së GOE MADEKOS SH.P.K. dhe GENIUS KOSOVA SH.P.K., kur pamundësia për t'i identifikuar dhe argumentuar ato është pasojë e drejtpërdrejtë e mohimit të qasjes nga AK-ja. Në përputhje me praktikën e mëparshme të OSHP-së, kërkojmë që AK-së t'i obligohet të mundësojë qasjen në dokumentacionin jo-konfidencial, të përgatisë versionet e pastruara dhe përmbledhjet jo-sekrete sipas kërkesave ligjore dhe, pas sigurimit të qasjes, të mundësohet shqyrtimi i plotë i përgjegjshmërisë së operatorit të rekomanduar

për kontratë, duke marrë parasysh edhe pretendimet tona ankimore.

PRETENDIMET LIDHUR ME PAPËRGJEGJSHMËRINË E OPERATORIT EKONOMIK TË REKOMANDUAR PËR KONTRATË

3.1. Lot 3, Pozicioni 1 - Sistemi laboratorik i integruar për Biokimi Klinike, Imunokimi dhe ISE

Pretendojmë se pajisja e ofertuar nga GOE MADEKOS SH.P.K. dhe GENIUS KOSOVA SH.P.K. nuk dëshmohet se i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me sistemin laboratorik të integruar dhe platformën e vetme për Biokimi Klinike, Imunokimi dhe ISE.
Kërkesa e Autoritetit Kontraktues nuk kufizohet vetëm në ofrimin e pajisjeve që mund të kryejnë analiza të veçanta, por kërkon një sistem laboratorik të integruar, i cili përmbush funksionalitetet e përcaktuara në dosjen e tenderit.
Në këtë drejtim, konsiderojmë se dokumentacioni teknik i pajisjes së ofertuar duhet të dëshmojë qartë përmbushjen e kërkesës për integrim funksional, menaxhimin e mostrave dhe realizimin e analizave të kërkuara në kuadër të një sistemi të integruar. Përderisa këto karakteristika nuk mund të prezumohen vetëm nga emërtimi i pajisjes ose nga përshkrimet e përgjithshme të saj, oferta nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme pa dëshmi të qarta për përmbushjen e kërkesave teknike.
Rrjedhimisht, nëse dokumentacioni i ofertuar nuk dëshmon përmbushjen e kërkesës për sistem të integruar dhe platformë të vetme, atëherë kemi të bëjmë me mospërmbushje të një kërkese të detyrueshme të dosjes së tenderit.

3.2. Lot 3, Pozicioni 2 - Pajisja e biokimisë klinike: mospërputhja e mundshme e gjatësive valore dhe ndikimi në menynë analitike

Pretendojmë se pajisja e biokimisë klinike e ofertuar nga GOE MADEKOS SH.P.K. dhe GENIUS KOSOVA SH.P.K. mund të mos i përmbushë kërkesat teknike të dosjes së tenderit lidhur me numrin dhe intervalin e gjatësive valore të sistemit optik.
Nga karakteristikat teknike të pajisjes së ofertuar ekziston dyshimi se sistemi optik ka numër ose interval të gjatësive valore më të kufizuar sesa ai i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.
Një kufizim i tillë nuk përbën vetëm dallim formal teknik, por mund të ndikojë drejtpërdrejt në funksionalitetin dhe kapacitetin analitik të pajisjes, përkatësisht në realizimin e metodave të caktuara biokimike, numrin e parametrave që mund të analizohen dhe përdorimin e aplikacioneve analitike që kërkojnë gjatësi valore specifike.
Për rrjedhojë, nëse karakteristikat e sistemit optik të pajisjes së ofertuar nuk përputhen me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, kjo përbën mospërmbushje të specifikimeve teknike dhe ndikon drejtpërdrejt në përgjegjshmërinë e ofertës së operatorit të rekomanduar.

PRETENDIMET ANKIMORE LIDHUR ME PËRPUTHSHMËRINË E PAJISJEVE TONA TË OFERTUARA ME SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Karrigia gjinekologjike Nagidos 3 -3 Motors pika 3.12.e

Konsiderojmë se pajisja e ofertuar e përmbush kërkesën funksionale të sigurisë të përcaktuar në specifikimin teknik.

Sipas dokumentacionit dhe sqarimit të prodhuesit, sistemi i komandimit funksionon sipas parimit *hold-to-run*, ku lëvizja e motorëve për rregullimin e mbështetëses së shpinës, lartësisë dhe pozicionit Trendelenburg vazhdon vetëm për aq kohë sa operatori mban të shtypur butonin përkatës dhe ndërpritet menjëherë me lirimin e tij. Ky mekanizëm siguron ndërprerjen e lëvizjes së pajisjes dhe parandalon vazhdimin e saj pa komandimin aktiv të operatorit. Për këtë arsye, vlerësojmë se AK-ja është mbështetur vetëm në mungesën e një butoni fizik të veçantë, pa e vlerësuar funksionalitetin real të sistemit të komandimit dhe funksionin e sigurisë që realizon pajisja e ofertuar.

2. Sistemi laboratorik Biolumi CX8 - pika 1.1

Pajisja e ofertuar Biolumi CX8, e prodhuar nga SNIBE, përmbush kërkesën për sistem laboratorik të integruar, pasi kombinon modulin e biokimisë klinike Biossays C8 dhe modulin e imunokimisë MAGLUMI X8 në një zgjidhje të përbashkët laboratorike. Sipas dokumentacionit të prodhuesit, sistemi identifikohet si *Integrated System*. Mostrat vendosen në zonën e dedikuar të ngarkimit dhe drejtohen automatikisht drejt modulit përkatës analitik, varësisht nga analizat e kërkuara. Prania e dy moduleve të specializuara nuk nënkupton se kemi të bëjmë me dy pajisje të pavarura, pasi ato janë pjesë e konfigurimit të integruar Biolumi CX8. Për rrjedhojë, konsiderojmë se AK-ja nuk e ka vlerësuar pajisjen në tërësinë e konfigurimit dhe funksionimit të saj, por është mbështetur në strukturën modulare për ta konsideruar atë si të papërputhshme me kërkesën për një platformë të vetme. Në këtë drejtim, dëshirojmë të theksojmë një element të rëndësishëm të dokumentacionit të dorëzuar në ofertën tonë: Certifikata e Konformitetit e bashkëngjitur në ofertë e identifikon Biolumi CX8 si pajisje të vetme (monolite) të certifikuar, ndërsa MAGLUMI X8 dhe Biossays C8 identifikohen gjithashtu si pajisje/modulë përbërës të këtij konfigurimi.

3.3. Lot 3, Pozicioni 3 - Analizatori hematologjik: mospërmbushja e kërkesave për mënyrat e punës dhe karakteristikat teknike

Pretendojmë se analizatori hematologjik i ofertuar nga GOE MADEKOS SH.P.K. dhe GENIUS KOSOVA SH.P.K. nuk dëshmohet se i përmbush të gjitha kërkesat teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit, në veçanti kërkesën për analizimin e mostrave përmes të dy mënyrave të punës, Open Tube dhe Closed Tube, sipas pikës 3.4 të specifikimeve teknike.
Mundësia e realizimit të analizave përmes të dy sistemeve të kërkuara përbën karakteristikë funksionale të pajisjes dhe nuk mund të konsiderohet e përmbushur vetëm në bazë të përshkrimeve të përgjithshme të analizatorit.
Për më tepër, përgjegjshmëria e pajisjes duhet të vlerësohet në raport me të gjitha kërkesat e detyrueshme të përcaktuara në dosjen e tenderit, përfshirë kapacitetin analitik, diferencimin leukocitar 5-Part, vëllimin e mostrës, parametrat hematologjikë dhe sistemin e kontrollit të cilësisë.
Nëse dokumentacioni teknik i modelit konkret të ofertuar nuk dëshmon përmbushjen e këtyre kërkesave, oferta e operatorit të rekomanduar nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme për këtë pozicion.

3.4. Karriget gjinekologjike - mospërmbushja e kërkesave teknike, funksionale dhe të sigurisë

Pretendojmë se karriget gjinekologjike të ofertuar nga GOE MADEKOS SH.P.K. dhe GENIUS KOSOVA SH.P.K. nuk dëshmohet se i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe të sigurisë të përcaktuara në dosjen e tenderit.
Specifikimet teknike të Autoritetit Kontraktues përcaktojnë kërkesa konkrete lidhur me konstruksionin metalik dhe rezistencën ndaj korrozionit, kapacitetin maksimal të peshës së pacientit prej së paku 180 kg, materialin dhe karakteristikat higjienike të tapicerisë dhe dyshekut, trashësinë e dyshekut, numrin dhe funksionet e motorëve elektrikë, rregullimin e lartësisë dhe mbështetëses së shpinës, pozicionet Trendelenburg dhe anti-Trendelenburg, rregullimin e pjesës së legenit, mbështetëset anatomike, legenin prej çeliku inox, telekomandën, rrotat, mekanizmin e frenimit, dimensionet dhe aksesorët e kërkuar.
Në veçanti, specifikimet teknike kërkojnë ndërprerës fizik emergjent, si dhe sisteme të mbrojtjes elektrike. Përmbushja e kësaj kërkese duhet të dëshmohet përmes dokumentacionit zyrtar të prodhuesit dhe karakteristikave konkrete të modelit të ofertuar.
Konsiderojmë se një pajisje nuk mund të vlerësohet si e përgjegjshme vetëm mbi bazën e përshkrimeve të përgjithshme

ose të karakteristikave që nuk dëshmojnë përmbushjen e secilës kërkesë të detyrueshme. Për rrjedhojë, nëse dokumentacioni i ofertuar nuk dëshmon përmbushjen e kërkesave të mësipërme, oferta e operatorit të rekomanduar nuk i plotëson kriteret teknike të dosjes së tenderit.

PËRFUNDIMET DHE KËRKESA PËRFUNDIMTARE

Duke u bazuar në pretendimet ankimore të paraqitura, argumentet dhe provat e bashkëngjitura, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që:

1. **Të aprovojë plotësisht ankesën tonë** si të bazuar;
2. Të konstatojë se vendimi i Autoritetit Kontraktues për shpalljen e ofertës sonë të papërgjegjshme dhe rekomandimin për kontratë të GOE MADEKOS SH.P.K. dhe GENIUS KOSOVA SH.P.K. nuk është marrë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat përkatëse të LPP-së;
3. **Të anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës dhe ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim**, duke obliguar Autoritetin Kontraktues që rivlerësimin ta realizojë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, dokumentacionin e ofertave dhe parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së drejtë;
4. Të obligojë Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit të shqyrtojë në mënyrë të plotë dhe të njëjtë dokumentacionin teknik të të gjithë operatorëve ekonomikë, duke vlerësuar përgjegjshmërinë e ofertave në përputhje me kriteret dhe specifikimet e përcaktuara në dosjen e tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne kete faze nuk ka.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*